




STATUT I QENDRES



" BE THE CHANGE "

Ne mbështetje të legjislacionit civil shqiptar dhe kryesisht në Ligjin nr. 8788 datë 7.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" dhe në Ligjin nr. 8789 datë 7.05.2001 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" si dhe të aktit të themelimit, në themelueset e qendres

Znj. Kristina QIRICI, bija e Rodolfit, lindur në Kucovë, me 10/06/19889 dhe banuese në Tiranë, me Letër Njoftimi ID me Nr. personal I95610070G

Znj. Eleni MORAITI BAIRAKTARI, shtetase greke, bija e Konstandinos, lindur në Holargos - Papagu, Greqi, me 18/04/1989 dhe banuese në Athinë, me Kartë Identiteti greke me Nr. AI961332

Redaktojmë statutin e Qendres " BE THE CHANGE ", në zbatim të aktit të themelimit dhe me kushtet që vijojnë:

Neni 1

Lloji dhe emrtimi

Themelohet Qendra " BE THE CHANGE " në shqip " BE NDRYSHIMIN " (më poshtë referuar "Qendra") që është një organizatë joqeveritare, jofitimprurëse e paantari.

Neni 2

Qendra e ka selinë e saj në adresën: Rr.Kavajes, Pall. SPEED, kati parë, Tiranë. Me vendim të Bordit të Drejtorëve, Qendra mund të hapë degë të saj dhe të emërojë përfaqësues edhe në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë shtetit. Qendra mund të hapë llogari bankare në Shqipëri dhe jashtë saj.

Neni 3

Identiteti i Themeluesve

Themeluese të qendres janë :

Znj. Kristina QIRICI, bija e Rodolfit, lindur në Kucovë, me 10/06/19889 dhe banuese në Tiranë, me Letër Njoftimi ID me Nr. personal I95610070G

Znj. Eleni MORAITI BAIRAKTARI, shtetase greke, bija e Konstandinos, lindur në Holargos - Papagu, Greqi, me 18/04/1989 dhe banuese në Athinë, me Kartë Identiteti greke me Nr. AI961332

Neni 4

Objekti dhe fusha e veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së qendres është :

- Edukimi në fushën e psikoterapisë dhe keshillimit shkencor në fushën e aplikimit të teorisë psikoterapeutike në shëndetesi, në arsim dhe orientimin e mjekeve psikologeve, punonjësve social e, infermiereve të psikiatrive dhe të shkencave të tjera

- Studimi dhe hulumtimi i teorisë dhe praktikës së psikoterapeutikës dhe keshillimit
- Mbrojtja e moralit konsultativ –psikoterapeutik sipas përcaktimeve në kodin etik
- Ofrimi i shërbimeve shoqërore për grupet në nevojë përmes dhënies së psikoterapisë , trajnimit dhe /ose keshillimit
- Organizimi i kurseve të trajnimit e seminareve si dhe një qendër trajnimit dhe aktiviteteve edukative
- Bashkëpunimi me universitete dhe qendra shkencore në Shqipëri dhe bërja e studimeve të përbashkëta
- Ngritja dhe funksionimi i bibliotekës dhe veprimtaria editoriale dhe printimi e shpërndarja e artikujve të ndryshëm si në revistë të posaçme ashtu edhe në rrugë elektronike
- Hartimi i projekteve dhe aplikimi në projekte të ndryshme për të mundësuar bashkëveprim, bashkëpunim, shkëmbim përvojash, midis komunitetit me institucione, donatorë, biznese, organizata, shoqata, individë të ndryshëm vendas ose të huaj etj.
- Bashkëpunimi me organizata simotra jashtë vendit dhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me to
- Organizimi i seminareve , konferencave, kongreseve kombëtare e ndërkombëtare

Neni 5

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Qendrës është një periudhë të pacaktuar.

Neni 6

Organet e Qendres

Organet e qendres janë:

Bordi Drejtoreve

Drejtori Ekzekutiv

Organi më i lartë vendimmarrës i Qendrës është Bordi i Drejtoreve. Bordi përbëhet nga tre anëtarë, të cilët emërohen nga themeluesja e Qendrës. Bordi i Drejtoreve do të përbëhet nga:

Kristina QIRICI, Eleni MORAITI BAIRAKTARI dhe Asimina CHIONI

Drejtor ekzekutiv emërohet znj. Kristina QIRICI , e cila ka të drejtën me mandat 3 vjeçar me të drejtë perseritje


Neni 7

Drejtori Ekzekutiv

Drejtor Ekzekutiv e Qendres do të jetë Znj. Kristina QIRICI. Drejtori do të përfaqësojë Qendrën në të gjitha aktivitetet e saj dhe ai ka të drejtën e firmës në llogaritë bankare në Shqipëri dhe jashtë saj.

Neni 8

Bordi i Drejtoreve përveç çështjeve të tjera të cilat ai i çmon se duhet të shqyrtohen prej tij vendos për:

- 
- Ndryshimin e Statutit;
 - Përcakton fushat dhe programin e veprimtarisë së Qendrës;
 - Mblidh dhe kontrollon rregullisht realizimin e veprimtarisë së Qendrës;
 - Shqyrton çështjet ekonomike financiare dhe të administrimit të Qendrës;
 - Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, organizimin dhe strukturën e Qendrës;
 - Zgjedh dhe emëron anëtarët e organit më të lartë ekzekutiv;
 - Krijon komitete të posaçme, si edhe për çështje të tjera të parashikuar shprehimisht ose në statut

Neni 9

Vendimet e Bordit të Drejtorëve merren me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Bordit të Drejtorëve. Vendimet për ndryshimin e Statutit, të Aktit të Themelimit, për miratimin e rregulloreve të brendshme merren me 2/3 e votave. Drejtori Ekzekutiv thërret Bordin e Drejtorëve të paktën 1 herë në vit në menyre virtuale online ose personalisht. Bordi i Drejtorëve mund të mbledhet jo vetëm në selinë e saj qendrore, por edhe jashtë kësaj selie në çdo vend të caktuar nga Drejtori Ekzekutiv.

Neni 10

Organi më i lartë ekzekutiv i Qendrës është Drejtori Ekzekutiv. Drejtori Ekzekutiv zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve. Ai e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit.

Neni 11

Drejtori Ekzekutiv gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij ka këto kompetenca:

- Realizon veprimtarinë e përditshme dhe ekzekuton programet e vendosura nga organi më i lartë vendimmarrës;
- Përgatit projekt programin vjetor të aktiviteteve dhe projektbuxhetin të cilat ia paraqet për miratim Bordit të Drejtorëve;
- Drejton veprimtarinë e Qendrës, në bazë të Statutit;
- Hyn në marrëdhënie me organizma të tjerë vendase dhe të huaja.
- Kryen çdo levizje financiare në autonomi të plote.

Neni 12

Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve të Qendrës thirren me kërkesën e Drejtorit Ekzekutiv, në varësi të projekteve dhe veprimtarisë, por asnjëherë më rrallë se 1 (një) herë në vit. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave.

Neni 13

Pronat e Qendrës administrohen sipas një rregulloreje të caktuar me vendim të bordit të drejtorëve, të përgjegjës për financën dhe drejtorit ekzekutiv.

Neni 14

Qendra mund shperndahet ne përfundim te misionit te saj dhe me vendim të drejtorit ekzekutiv dhe mbështetjen e bordit. Bashkimi i qendres me organizma te tjere vendoset nga drejtori i saj me mbështetjen e bordit dhe në ato raste kur misionet e organizatave plotesojne ojera -tjetren.

Neni 15

Qendra perfaqesohet ligjërish nga Drejtori i saj ekzekutiv dhe ne mungese te tij nga personat e mandatuar nga ai.

Neni 16

Mbas shpërndarjes se Qendrës, likuidimi apo shperndarja e pasurive te saj behet ne baze te legjislacionit ne fuqi dhe ne baze te parimit të ndalimit te shperndarjes se fitimeve.

Neni 17

Te ardhurat e Qendres sigurohen nga:

- Kontributet e themelueseve;
- Te ardhura dhe financime nga donatore vendas dhe te huaj;
- Te ardhura te siguruara nga veprimtaria e vete Qendres;

Kontributi fillestar i themelueses eshte nje shume ~~50.000 (pesedhjetemije mijë)~~ leke, te depozituara ne emer dhe llogari te qendres.

Neni 18

Ky Statut redaktohet ne 3 (tre) ekzemplare ne gjuhen shqipe , Statuti u redaktua ne tre ekzemplare ne gjuhen shqipe , themeluesit e lexuan me ze te larte dhe te qarte , te cilat deklaruan se e kuptuan pasi ju perkthye znj **Eleni MORAITI BAIRAKTARI** dhe meqenese e gjeten ne perputhje me kerkesen dhe vullnetin e tyre te lire dhe te plote e nenshkruan ate pa verejtje.

THEMELUESIT

Kristina QIRICI

Kristina Qirici

Eleni MORAITI BAIRAKTARI

[Signature]

Eleni

Moraiti Bairaktari

[Signature]



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ANDI F. RIZAJ
ADRESA NR.10, KONT URANI, NR.51
TEL: 694001353



VËRTETIM NËNSHKRIMI NË AKTE TË NDRYSHME OSE NË DEKLARATA PERSONALE

Nr. repertori: 2391

Tirane më 23/05/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



V2023053310204779769

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER ANDI F. RIZAJ



V2023053310204779769

DATE 23/05/2023
NR REP. 2391

VËRTETIM NËNSHKRIMI



Sot, më datë 23 Maj 2023 (dy mijë e njetzet e tre), ditën e Marte, para meje **Noter ANDI F. RIZAJ**, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.10, KONT URANI, NR.55 u paraqit personalisht:

DEKLARUESIT:

1.Eleni Moraiti-Bairaktari, atësia Konstandinos, shtetase Greke, lindur në Mapia dhe banues në Greqi, lindur më 18/04/1989, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me nr. personal AL961332, përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e posaçme" me Nr. Rep 2544, Nr. kol 776, hartuar nga noter FATMIR LACEJ, në datë 07/05/2022, nga përfaqësuese **Kristina Qirici**, atësia Rodolf, amësia Liljana, shtetase shqiptare, lindur në Kuçovë, Berat dhe banuese në Tiranë, me adresë MUHAMET GJOLLESHA; Nd. 58; H. 1; ; NJËSIA ADMINISTRATIVE NR. 7; NJËSIA BASHKIAKE NR. 7; 1023; TIRANË, lindur më 10/06/1989, gjendja civile e martuar, madhore me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e së cilës u garantova nga karta e identitetit me nr. personal I95610070G.

2.Stela Kumati, atësia Nasho, amësia Ludja, shtetase Shqiptare, lindur në Berat dhe banues në TIRANË, me adresë Artan Lenja; Nd. 57/1; H. 4; Ap. 70; Njësia Administrative Nr. 7; Njësia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 15/04/1981, gjendja civile "beqare", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035684061 dhe nr. personal I15415175A, .

3.Julian Leskaj, atësia Nuri, amësia Donika, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në TIRANË, me adresë E Kavajës; Nd. 133; H. 10; Ap. 35; Njësia Administrative Nr. 10; Njësia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 15/08/1979, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 036911082 dhe nr. personal H90815143M, .

Subjektet e mësipërme, në vullnet të lirë dhe të plotë, u paraqitën dhe nënshkruan përpara meje Noterit, "**Statut i Qendres "Be the Change" OJF**", bashkëlidhur.

Unë Noteri, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

ANDI F. RIZAJ

STATUT

i Qendres "Be the Change"

Në mbështetje të Legjislacionit Shqiptar në fuqi, ligjit nr. 8788, datë 03.05.2001 "Për organizatat Jofitimprurëse" dhe ligjit 80/2021 "Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse" me vullnet të lirë të bordit drejtues, është hartuar ky statut i **Qendres "Be the Change"**, si vijon :

Neni 1

Dispozita hyrëse

Ky statut përcakton parimet kryesore të organizimit dhe të zhvillimit të aktivitetit të Organizatës Jofitimprurëse me emërtimin Qendra " **Be the Change**".

Neni 2

Emri, Forma e organizimit

Emri i Qendres, eshte **Qendra " Be the Change"**

Ajo është një organizatë jofitimprurëse, pa anëtarësi e cila nuk ndjek qëllime politike, tregtare, biznesi dhe fetare në formën e "Qendrës".

Ajo fiton personalitet juridik pasi të jetë regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 3

Qëllimi

Qëllimi i veprimtarisë së "**Be the Change**" do të jetë ofrimi i asistencës teknike, konsulencë, ofrim shërbimesh ndërmjetësimi, kërkimi, studimi drejtim projektësh dhe shërbimeve lidhur me veprimtaritë të ndryshme që zhvillohen në sektorin publik dhe në përfitim të komunitetit.

Organizimin programesh, kursesh, si dhe ngritja e platformave dixhitale për aktivitetet me veprimtari rinore dhe inovative:

Kërkimi, studimi dhe lobimi për çështje, edukimi, rinorë dhe inovative;

Trajnimi i individëve, organizatave, institucioneve të pavarura dhe akademike, institucionet në nivel vendor dhe qëndror dhe subjekteve të tjera shtetërore apo private për çështjet që lidhen me shtetin e së drejtës, integrimin europian, të drejtat e njeriut, demokracia dhe qeverisja e mirë;

Luajtja e një roli ndërmjetësues dhe bashkëpunimit midis partnerëve europianë dhe shqiptarë në fusha të ndryshme me një fokus të veçantë në rrjetet e informacionit dhe komunikimit për çështjet e rinisë, psikologjisë dhe inovacionit;

Luajtja e një roli ndërmjetësues midis autoriteteve publike edhe publikut me qëllim adresimin e nevojave të publikut dhe rritjes së besimit tek zyrtarët publikë;

Organizimi i anketave publike për çështje që lidhen objektin e Qendres.

Botimet dhe publikimet.

Krijimi i një infrastrukture informacioni si dhe grumbullimi, klasifikimi, përpunimi dhe analizimi i tij, për të gjitha fushat që janë objekt i veprimtarisë së Qendrës;

Ofrimi i asistencës apo konsulencës për subjekte shtetërore apo private, vendase dhe të huaja në lidhje me çështje të të drejtave të njeriut, integritetit evropian;

Lehtësimi dhe krijimi i rrjeteve specifike sipas çështjeve (issue networks) përmes strategjive gjithëpërfshirëse në funksion të mobilizimit civil për çështje sensitive ligjore, territoriale, të sektorit të drejtësisë dhe të mjedisit;

Organizimin e aktiviteteve të ndryshme për përmbushjen e qëllimeve të mësipërme.

Ofrimi i ekspertizës në fushën e arsimit dhe edukimit rinorë dhe shkencës organizatave publike, private, shqiptare ose të huaj;

Asistencë në hartim strategjish zhvillimi, në menaxhimin e kurrikulave;

Asistencë në procesin e vlerësimit dhe akreditimit të institucioneve arsimore dhe programeve të studimit që ata ofrojnë;

Të realizojë studime/ pyetësorë/ sondazhe në lidhje me sistemin dhe procesin e arsimit;

Të ofrojë trajnime për stafin pedagogjik dhe drejtues kërtire institucioneve arsimore publike ose privatë, shqiptarë ose të huaj.

Studime dhe hulumtime të teorisë dhe praktikës së psikoterapeutikës dhe keshillimit.

Ofrimi i shërbimeve shoqërore për grupet në nevojë përmes dhenies së psikoterapise trajnimit dhe keshillimit.

Përveç veprimtarisë të parashikuar më lart, në veprimtarinë e qendrës mund të përfshihet çdo veprimtari tjetër jo fitimprurëse, e cila vlerësohet nga themeluesit e nevojshme dhe e përshtatshme për realizimin e qëllimit të qendrës. Në çdo rast zgjerimi i objektit të Qendrës, vendoset në Statut, ndryshimet e të cilit miratohen nga Bordi Drejtues.

Neni 4

Objektivat

Misioni i Qendres “**Be the Change**“ do të jetë ofrimi i asistencës teknike, konsulence, ofrim shërbimesh ndërmjetësimi, kërkimi, studimi drejtim projektësh dhe shërbimeve lidhur me veprimtaritë të ndryshme që zhvillohen në sektorin publik dhe në përfitim të komunitetit.

Organizimin e programesh, kursesh, si dhe ngritja e platformave dixhitale për aktiviteteve me veprimtari rinore dhe inovative:

Kërkimi, studimi dhe lobimi për çështje, edukimi, rinorë dhe inovative;

Trajnimi i individëve, organizatave, institucioneve të pavarura dhe akademike, institucionet në nivel vendor dhe qëndror dhe subjekteve të tjera shtetërore apo private për çështjet që lidhen me shtetin e së drejtës, integritetin evropian, të drejtat e njeriut, demokracia dhe qeverisja e mirë;

Luajtja e një roli ndërmjetësues dhe bashkëpunimit midis partnerëve evropiane dhe shqiptarë në fusha të ndryshme me një fokus të veçantë në rrjetet e informacionit dhe komunikimit për çështjet e rinisë, psikologjisë dhe inovacionit;

Luajtja e një roli ndërmjetësues midis autoriteteve publike edhe publikut me qëllim adresimin e nevojave të publikut dhe rritjes së besimit tek zyrtarët publikë;

Organizimi i anketave publike për çështje që lidhen objektin e Qendres.

Botimet dhe publikimet.

Krijimi i një infrastrukture informacioni si dhe grumbullimi, klasifikimi, përpunimi dhe analizimi i tij, për të gjitha fushat që janë objekt i veprimtarisë së Qendrës;

Ofrimi i asistencës apo konsulencës për subjekte shtetërore apo private, vendase dhe të huaja në lidhje me çështje të drejtave të njeriut, integritit evropian;

Lehtësimi dhe krijimi i rrjeteve specifike sipas çështjeve (issue networks) përmes strategjive gjithëpërfshirëse në funksion të mobilizimit civil për çështje sensitive ligjore, territoriale, të sektorit të drejtësisë dhe të mjedisit;

Organizimin e aktiviteteve të ndryshme për përmbushjen e qëllimeve të mësipërme.

Ofrimi i ekspertizës në fushën e arsimit dhe edukimit rinorë dhe shkencës organizatave publike, private, shqiptare ose të huaj:

Asistencë në hartim strategjish zhvillimi, në menaxhimin e kurrikulave;

Asistencë në procesin e vlerësimit dhe akreditimit të institucioneve arsimore dhe programeve të studimit që ata ofrojnë;

Të realizojë studime/ pyetësorë/ sondazhe në lidhje me sistemin dhe procesin e arsimit;

Të ofrojë trajnime për stafin pedagogjik dhe drejtues kërtire institucioneve arsimore publike ose privatë, shqiptarë ose të huaj.

Studime dhe hulumtime te teorise dhe praktikes se psikoterapeutikes dhe keshillimit.

Ofrimi i shërbimeve shoqërore për grupet në nevojë përmes dhenies së psikoterapise trajnimit dhe keshillimit.

Përveç veprimtarisë të parashikuar më lart, në veprimtarinë e qendrës mund të përfshihet çdo veprimtari tjetër jo fitimprurëse, e cila vlerësohet nga themeluesit e nevojshme dhe e përshtatshme për realizimin e qëllimit të qendrës. Në çdo rast zgjerimi i objektit të Qendrës, vendoset në Statut, ndryshimet e të cilit miratohen nga Bordi Drejtues.

Neni 5

Kohëzgjatja

Qendra krijohet për një afat të pakufizuar. Kohëzgjatja mund të kufizohet nga një vendim i motivuar i Bordit Drejtues dhe me pjesëmarrjen e shumicës, ashtu sikundër mund të zgjatet në të njëjtën mënyrë. Përfundimi i veprimtarisë së Qendrës bëhet me vendim të Bordit Drejtues ose me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas kushteve të parashikuara në nenin 44 të ligjit "Për Organizatat Jofitimprurëse". Personaliteti juridik i Qendrës mbaron në ditën kur vendimi i Gjykatës për çregjistrimin e saj ka marrë formë të prerë.

Neni 6



Selia

Qendra e ka seline e saj ne Tirane, ne adrese Rruga e kavajes, pallati Speed, Kati I, Tirane, 1000.

Qendra e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Ajo mund të çelë degë brenda dhe jashtë vendit.

Neni 7

Pasuria e Qendrës

Të ardhurat e Qendrës do te sigurohen nga :

kontributi i themeluesve;

të ardhura dhe financime nga donatorë vendas dhe të huaj;

dhurata, ndihma, grante, kontribute dhe sponsorizime nga persona fizike dhe juridike, vendas dhe të huaj të dhëna pa kushtëzime që bien ndesh me kushtet e këtij statuti;

programet e financuara nga organizma ndërkombëtare, organizma dhe institucione e fondacione të huaja e kombëtare, borde lokale, rajonale, kombëtare e ndërkombëtare, zhvillimi i leksioneve, ekspozitave etj;

burime të tjera financimi, shprehimisht të lejuara prej ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Në çdo rast do të bëhet evidentimi i këtyre mjeteve financiare dhe do të hartohet dokumentacioni përkatës sipas ligjeve në fuqi.

Neni 8

Kriteret e administrimit të pasurisë

Administrimi i pasurive të Qendrës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi. Për të gjitha veprimtaritë ekonomike dhe financiare mbahet bilanc i rregullt që miratohet nga Bordi Drejtues.

Qendra ka llogaritë e saj bankare që çelen dhe operojnë sipas urdhërave të themeluesit.

Bordi Drejtues dhe donatorët e mundshëm kanë të drejte të kërkojnë në çdo kohë shpjegime rreth gjendjes financiare të Qendrës.

Neni 9

Miratimi i rregullave të brendshme

Rregulloret e brendshme të Qendrës dhe degëve të saj, ku përcaktohen normat e funksionimit të sektorëve të ndryshëm të Qendrës, raportet me të tretet, etj. hartohen nga stafi në zbatim të Statutit dhe Aktit të Themelimit dhe miratohen nga Bordi Drejtues.

Neni 10

Ndalimi i shpërndarjes së fondeve

Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e Qendrës do të përdoren në mënyrë ekskluzive për zhvillimin dhe zgjerimin e qëllimit të veprimtarisë së Qendrës. Këto të ardhura do të përdoren për qëllime statutores dhe nuk do t'i shpërndahen themeluesit të Qendrës, përveç detyrimeve në formën e pagesave, rrogave, shpërblimeve dhe kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose për mbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të Qendrës.

Cdo veprim i kundërt është plotësisht i pavlefshëm dhe organet përgjegjëse mbajnë përgjegjësi sipas ligjit.

Neni 11

Organet drejtuese



Organet drejtuese të Qendrës janë :

Bordi Drejtues
Drejtori Ekzekutiv

Qendra do të krijojë edhe borde nderi, anetare të cilëve do të jene personalitete të fushes së psikoterapisë pozitive vendas dhe të huaj.

Neni 12

Bordi Drejtues

Bordi Drejtues përbëhet nga 3 anetare:

1. Julian Leskaj
2. Stela Kumati
3. Eleni Morati Bairaktari

Anëtarët zgjidhen për një periudhë 3 vjecare me të drejtë rizgjedhje.

Neni 13

Kompetencat e Bordit Drejtues

Bordi Drejtues përveç çështjeve të tjera që çmon se duhet të shqyrtohen prej tij vendos për:
Ndryshimin e statutit ;

Përcakton fushat dhe programin e veprimtarisë së Qendrës dhe degëve të saj ;

Mbikqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e veprimtarisë;

Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit;

Miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e Qendrës dhe shpenzimet e saj;

Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, organizimit dhe strukturës organizative të Qendrës;

Zgjedh, emëron dhe shkarkon, anëtarët e organit më të lartë ekzekutiv;

Krijon komitete të posaçme si dhe çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj ose në statut;

Merr vendim për shpërndarjen, bashkimin ose transformimin e Qendrës në një organizate të nje forme tjetër;

Vendos për krijimin e degëve ose filialeve në rrethe ose jashtë vendit;

Vendos për zhvillimin e veprimtarisë ekonomike nga Qendra sipas ligjit me qëllim gjenerimin e të ardhurave;

Miraton aktivitete për mbledhjen e fondeve, sipas nenit 37 të ligjit “ Për organizatat jofitimprurëse”;

Emëron likuiduesit;

Shqyrton raportin e likuiduesve;

Vendos për kalimin e pasurive në subjekte të tjera në rast shpërndarje të Qendrës.

Neni 14

Drejtori Ekzekutiv


Drejtori Ekzekutiv është organ individual, i cili përcaktohet në Statut dhe ka të drejtë rizgjedhje të pakufizuar.

Drejtor ekzekutiv është Kristina Qirici.

Neni 15

Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutiv ka këto kompetenca gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij:



Administrimin e veprimtarisë së përditshme të Qendrës, në zbatim të statutit, vendimeve të Bordit Drejtues dhe legjislacionit në fuqi;
Realizon dhe ekzekuton programet e vendosura nga organi më i lartë vendimmarrës;
Përgatit projektprogramin vjetor të veprimtarive dhe projektbuxhetin e Qendrës, të cilat ia paraqet për miratim Bordit Drejtues dhe më pas kontrollon zbatimin e tyre;
Lidh kontratat e punës me stafin e Qendrës duke përdorur metodën e konkurimit të hapur e të lire, sipas kriterëve të përcaktuara nga Bordi Drejtues;
Përfaqëson Qendrën në marrëdhënie me institucione të ndryshme dhe me persona të tretë, brenda dhe jashtë vendit.

Neni 16 **Perfaqesuesi ligjor**

Përfaqësuesi ligjor i Qendrës është Drejtori Ekzekutiv .

Neni 17 **Rregullat për mbajtjen e mbledhjeve**

Bordi Drejtues mbledhet të paktën një herë në gjashtë muaj. Mbledhja e Bordit Drejtues thirret me kërkesë të Drejtorit Ekzekutiv ose me kërkesë të më shumë se gjysmës së anëtarëve të Bordit Drejtues. Mbledhja njoftohet me shkrim të pakten 7 dite përpara duke bërë të ditur datën, orën, vendin e zhvillimit të saj dhe rendin e ditës.

Neni 18 **Pjesëmarrja**

Mbledhja e Bordit Drejtues është e vlefshme kur në të marrin pjesë më shumë se gjysma e anëtarëve. Në mbledhjen e Bordit merr pjesë dhe Drejtori Ekzekutiv, apo persona të tjerë të ftuar, pa të drejta vote.

Neni 19 **Vendimmarrja**

Vendimet e Bordit Drejtues merren me votën pro të shumicës së anëtarëve të pranishëm të anëtarëve të Bordit. Votimi është i fshehtë, përveç rasteve të veçanta kur Bordi Drejtues mund të vendosë ndryshe. Çdo vendim i Bordit dhe procesverbalet përkatëse të mbledhjeve nënshkruhen nga Kryetari i Bordit. Një punonjës i stafit, i caktuar nga Drejtori Ekzekutiv kryen detyrën e sekretarit teknik të Bordit Drejtues.

Neni 20 **Bashkimi dhe ndarja e Qendrës**

Qendra me propozim të Drejtorit Ekzekutiv dhe miratimin e dhënë nga anëtarët e Bordit Drejtues, për arsye të lehtësirave që mund të krijohen nga bashkëpunimi gjithmonë në të mirë të arritjes së objektivave të Qendrës, mund të bashkohet ose të transformohet me organizata të tjera jofitimpruese pa anëtarësi. Qendra konsiderohet e shpërndarë me regjistrimin e subjektit të ri.

Neni 21 **Likuidimi**



Kur vendoset shpërndarja e Qendrës, Bordi Drejtues cakton një ose disa likuidues të cilët kanë autoritetin dhe pëëgjegjësinë mbi asetet, pasuritë dhe përfaqësimin e Qendrës që nga data e emërimit të tyre e deri ne përfundim të likuidimit.

Likuiduesit e kryejnë veprimtarinë e tyre në bazë të nenit 47 të ligjit "Për organizatat jofitimprare" dhe dispozitat e tjera ligjore në fuqi.

Me emërimin e likuiduesit ose te likuiduesve, Drejtori Ekzekutiv nuk ka më funksione. Kur shpërndarja e Qendrës vendoset me vullnet të lirë të Bordit Drejtues, ky organ kontrollon dhe miraton përfundimisht procedurat e likuidimit, miraton raportin përfundimtar të likuiduesit dhe i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për çregjistrimin e Qendrës. Nëse raporti përfundimtar i likuiduesve nuk miratohet nga Bordi Drejtues shqyrtohet nga Gjykata në prani të palëve. Likuiduesi ose likuiduesit emërohen me vendim të Bordit Drejtues.

Neni 22

Veprimtaria e likuiduesve

Likuiduesi ose likuiduesit, brenda dy muajve nga data e emërimit të tyre thërret mbledhjen e Bordit Drejtues, të cilit i paraqet raportin mbi gjendjen financiare të Qendrës, aktivin dhe pasivin e Qendrës, para se të fillojë operacioni i likuidimit.

Likuiduesi përfaqëson Qendrën dhe ka të gjitha kompetencat e nevojshme për likuidimin e pasivit të saj. Likuiduesi është i autorizuar të paguajë të gjithë kreditorët dhe më pas vlerëson pasurinë e mbetur dhe kujdeset që kjo pasuri të shkojë në destinacionin e përcaktuar nga statuti.

Neni 23

Destinimi i pasurisë pas shpërndarjes së Qendrës

Pasuria e Qendrës pas shpërndarjes së saj do t'u kalojë në mënyrë proporcionale të gjitha organizatave joqeveritare homologe të cilat veprojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe kanë objekt të ngjashëm ose fusha veprimtarie të përbashkëta .

Përrjashtim nga ky rregull përbëjnë te gjitha Qendrat, me të cilat Qendra, ka pasur projekte dhe programe të përbashkëta, të cilave në mënyrë preferenciale u kalon 40% te aktivit.

Neni 24

Dispozita tranzitore

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin midis anëtareve të Bordit Drejtues apo me struktura të tjera të Qendres do të behen përpjekje që të zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet tyre. Në të kundërt ato do t'i shtrohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky statut u hartua ne kater ekzemplarë origjinale në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë juridike. Pas leximit dhe gjetjes në rregull ai nënshkruhet me vullnet të plote pa vërejtje Bordi Drejtues i Qendres.

BORDI DREJTUES

Eleni Moraiti-Bairaktari

Perfaqesuar me Prokure nga :

Kristina Beira

[Signature]

Stela KUMATI

Stela Kumati

Julian LESKAJ

Julian Leskaj